# Fakte mbi Aktivitetin Filantropik

Maj 2017

Partnerët Shqipëri, si pjesë e misionit të saj në mbështetje të sektorit jo-fitimprurës në Shqipëri dhe forcimit të bashkëpunimit ndërsektorial, po punon për zhvillimin e filantropisë në vend. PSH ka realizuar:

- një seri studimesh mbi nivelin e zhvillimit të filantropisë në vend (**Aktiviteti Filantropik i Ndërmarrjeve në Shqipëri, studimi i dytë, 2016**; **Sipërmarrja dhe Filantropia-Raport i Studimit**; **Një Vështrim Historik mbi Zhvillimin e Filantropisë në Shqipëri**; **Përmbledhje vjetore mbi monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri, 2015** dhe **2016**),

- ndërhyrje afatgjata që synojnë evidentimin e këtij aktiviteti nga ana e sektorit të biznesit (**Çmimi i Filantropisë**),

- krijimin e platformave që sjellin më pranë biznesin me nisma që promovojnë përfshirjen sociale dhe zhvillimin ekonomik lokal (**Konkursi i Ideve të Gjelbërta**).

Për të tretin vit radhazi Partnerët Shqipëri po kryen **monitorimin e aktivitetit filantropik** në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike.

Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën dhe vlerën e dhurimeve, mbulimin gjeografik si dhe natyrën e dhuruesve. Ato vijnë në formën e informacionit të përmbledhur mujor që synon të ndihmojë në kuptimin dhe evidentimin e këtij aktiviteti.

*Mbledhja e të dhënave mbështetet nga Catalyst*.

**Gjatë muajit Maj 2017 vlera e dhurimit të raportuar në nivel vendi është *1,606,522 Lekë*, sipas të dhënave të mëposhtme. Të gjithë dhurimet e identifikuara janë kryer në *para*.**

# Fjalor

**Dhurime Sezonale –** Dhurime që kryen gjatë sezonit të festave

**Mix –** Dhurime të cilat kombinohen nga më shumë se një kategori / qytet.

**Ndihmë Ekonomike** - Dhurimet që janë kryer për zbutjen e varfërisë për individë apo familje që jetojnë me vështirësi ekonomike apo gjatë fatkeqësive natyrore

**NVM** – Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme

**OJF** - Organizata Jofitimprurëse

**Publik i Gjerë –** Një grup i vogël apo i madh njerëzish













[1]Për hater të analizës dhuruesit llogariten vetëm një herë pavarësisht numrit të dhurimeve të kryera gjatë periudhës së monitoruar.


Forma e Dhurimit
20%
40%
40%
Event
Thirrje për dhurim/Fushatë për ngritje fondesh
Dhurim i drejtpërdrejtë


Fusha e Dhurimit
20%
10%
20%
30%
20%
Shëndetsi
Zbutje e Varfërisë
Sipërmarrje Sociale
Mbështetje e Grupeve të Marxhinalizuara
Mjedis


Kanalet e Dhurimit
11%
11%
11%
11%
11%
45%
Individ apo Familje
OJF
Institucion - Shëndetsor
Institucion - Social
Mix
Biznes i Vogël


Përfituesit Përfundimtar
10%
10%
10%
10%
30%
30%
Publik i Gjerë - Nga një Zonë Gjeografike Specifike
Publik i Gjerë
Të rritur - Të moshuar
Të rritur - Me Probleme të Shëndetit Fizik
Publik i Gjerë - Me Vështirësi Ekonomike
Publik i Gjerë - Komuniteti LGBT


Shtrirja Gjeografike e Përfituesve
10%
10%
10%
20%
50%
Tiranë
Fier
Korçë
Kavajë
Gjirokastër